

**Prot. 2211/229 K (e-k)**

**Datë, 22/11/2022, Tiranë**

**Lënda:** Partia Lëvizja e Legalitetit

*Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin*

*financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!*

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin PLL, KRIIK ka konstatuar se:*

*- 1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e ka deklaruar këtë shpenzim;*

*- mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

### **Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të PLL për reklamë politike në Facebook dhe Instagram**

Kandidati i PLL z. Shpwtim Axhani, për faqen në *Facebook* të të cilit është paguar një shumë e pa identifikueshme saktësisht pasi është më e vogël se 100\$, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

### **Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve**

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezultoi se PLL nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim**

**dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania